

Wohnen & Pflege

Graf Recke Wohnen & Pflege u ofron të moshuarve dhe njerëzve në nevojë në Dyseldorf dhe Hilden shërbime përkujdesjeje dhe mbështetjeje në ambiente fikse, si dhe në shtëpi shërbimi. Përkujdesja dhe mbështetja ofrohen edhe në veri të Dyseldorfit përmes shërbimit ambulator të përkujdesjes recke:mobil, si dhe përkujdesjes ditore dhe komunitetit rezidencial në përgjegjësinë e ofruesit në Quartiershaus Am Röttchen.

Në Dorotheenviertel Hilden, Ahorn-Karree ka gjithashtu një ofertë speciale për personat me demencë të shkallës së rëndë.

Ekipe tona multiprofesionale dhe programi ynë i zgjeruar i trajnimit garantojnë që rezidentët dhe klientët t'i kalojnë vitet e pleqërisë në ndjesinë e këndshme të përkujdesjes që u jepet.

Qoftë kujdes intensiv, qoftë një ndihmë e vogël: Ne fokusohemi gjithnjë te nevojat individuale të rezidentëve dhe klientëve tanë.

Nga ambulantët te gjysmë-të brendshmit, të brendshmit, apo kujdesi në ambientin tuaj, qendrat tonë në Dyseldorf dhe Hilden, shtëpitë e shërbimit apo banesat e përbashkëta në Quartierhaus tonë ose ofertat për personat me demencë: Kontaktoni me ne për të gjetur ofertën e duhur për ju.



Puna si infermier

te Graf Recke Wohnen & Pflege

Me pasion dhe kompetencë
për rezidentët tanë

Detyrat tuaja

Ju mbështesni njerëzit që jetojnë me ne që të përballojnë jetën e përditshme. Ju i këshilloni, i motivoni të punojnë dhe të kalojnë kohën e tyre të litë, si dhe kryeni detyrat e infermierit dhe mjekësore.

Ju jeni përgjegjës për planifikimin e procesit dhe për dokumentacionin e përkujdesjes, kujdeseni për menaxhimin e mjekimit dhe të rrezikut, si dhe implementoni menaxhimin tonë të cilësisë.

Përveç detyrave të infermierit dhe të përkujdesjes, pjesë e detyrave tuaja janë edhe organizimi, si dhe administrimi.

Çfarë ju ofrojmë

Ju do të merrni shpërblim sipas tarifës të punonjësit federal në versionin kishtar (BAT-KF).

Për më tej, do të merrni një pagesë të posaçme vjetore, një pension suplementar nga kompania në rastin e pensionit, gjashtë javë leje të paguar dhe përfitime në asete.

Gjithashtu, ju ofrohet edhe trajnimi ynë i zgjeruar i brendshëm, si dhe programi i kualifikimit të mëtejshëm për të thelluar njohuritë tuaja.



A jeni nga jashtë shtetit?

A keni ardhur te ne nga jashtë shtetit dhe keni nevojë për ndihmë për të gjetur akomodim, për të shkuar në zyrë apo pyetje të tjera të përditshmërisë?

Ne do t'ju mbështesim me kënaqësi dhe do t'ju ndihmojmë të zhvendoseni në një shtet të huaj sa më shpejt të jetë e mundur. Mos hezitoni të na kontaktoni.

Kontakt



Joachim Köhn
Drejtues departamenti
Einbrunger Str. 66
40489 Düsseldorf
Telefon 0049. 211. 4055-4930
j.koehn@graf-recke-stiftung.de
Gjuhët: Gjermanisht, anglisht

NA TELEFONONI.
JEMI NË PRITJE
PËR

JU !

Kemi kënaqësinë t'u përgjigjemi pyetjeve tuaja në një takim informues konfidencial.

